

LIGJI Nr. 03/L-131

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/17 PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

**LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/17 ‘PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE’**

Neni 1

Në nenin 2 pas përkufizimit “çmimi i shitjes së mallit” shtohen edhe tri përkufizime të reja me tekstin si vijon:

“**Shërbime publike**” nënkuptohet shpërndarja ose/dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, energji termike, ujë të pijshëm, kullimi dhe spastrimi i ujërave të zeza, transportimi i udhëtarëve në transportin publik, shërbimet postare, mirëmbajtja e pastërtisë, si dhe deponimi i hedhurinave komunale.

“**Shitja me aksion**” nënkupton shitjen e caktuar të mallrave të një prodhuesi, në kohë dhe në vend të caktuar, sipas çmimit më të ulët se çmimi i rregullt i atij malli.

“**Shitblerja në largësi**” nënkupton mundësinë e blerjes së mallit dhe të shërbimit pa praninë fizike të shitësit dhe të blerësit, me anë të letër dërgesës, telefaksit, letërkëmbimit ose internetit.

Neni 2

Në nenin 7 pas paragrafit 7.5, shtohen katër paragraf të rinj me tekstin si vijon:

6. Tregtari është i detyruar që, sipas përcaktimit të konsumatorit, brenda mundësive, mallin me gabime ta ndërrojë me mall tjetër të njëjtë, në gjendje të rregullt ose ta kthejë shumën e pagesës për këtë mall, përkatësisht ta zbrësë çmimin ose t'i heqë mangësitë e mallit. Shpenzimet e ngarkim-shkarkimit dhe të transportimit të mallit i mbulon tregtari, sipas faturës reale.

7. Mangësia në mall përkatësisht në shërbimin e kryer, kur një gjë e tillë është e domosdoshme, verifikohet me anë të ekspertizës nga institucionet e autorizuara. Shpenzimet e ekspertizës i përballon konsumatori ose tregtari varësisht nga rezultati i ekspertizës.

8. Ekspertiza mund të iniciohet nga konsumatori, përmes Shoqatës së konsumatorit ose të Inspektoratit të tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë.

9. Tregtari është i detyruar, brenda afatit të garancisë, t'i përmirësojë mallin dhe shërbimin e kontestuar, për të cilin konsumatori e jep dëshminë e pagesës. Po që se përmirësimi i mallit nuk është i mundshëm, tregtari duhet t'ia japë mallin tjetër të njëjtë, por në gjendje të rregullt.

Neni 3

Në nenin 11 pas paragrafit 11.3 shtohet edhe një paragraf i ri, me tekstin si vijon:

4. Personi i huaj, që ka vendqëndrim në Republikën e Kosovës, i gëzon të gjitha të drejtat, si konsumatori vendor.

Neni 4

Pas nenit 14 shtohet neni i ri 14. A, me titullin dhe tekstin si vijon:

Neni 14 A Premtim i shpërblimit

Tregtari është i obliguar t'ia japë konsumatorit dhuratën e paraparë sipas shpalljes publike me rastin e blerjes së mallit ose të shfrytëzimit të shërbimit përkatës.

Neni 5

Ne nenin 20 pas paragrafit 20.2 shtohen edhe dy paragrafë të rinj me tekstin si vijon:

3. Lirimi i mallrave, sipas paragrafit 1 të këtij neni, të shumtën e rasteve bëhet për shkak të përfundimit të sezonit, të evidencimit të mallit me gabime, të afrimit të kalimit të aftit, të shitjes në panaire ose në dyqane të specializuara.

4. Tregtari është i obliguar të mbajë evidencën kontabël të gjendjes para zbritjes, dhe t' i ofrojë prova autoriteteve mbi lirimin e çmimeve sa here i kërkohet.

Neni 6

Pas nenit 21, shtohen nenet 22 A, 22 B dhe 22 C me tekstin si vijon.

Neni 22 A Shërbimet publike të cilat u ofrohen konsumatorëve

1. Shitja e shërbimeve publike konsumatorit i përlogaritet sipas çmimeve të caktuara nga Autoriteti i Rregullatorit përkatës.

2. Shërbimi për leximin e aparateve matëse bëhet pa pagesë, me përjashtim të rastit kur konsumatori kërkon lexim jashtë afatit të paraparë me akte nënligjore.

3. Ofruesi i shërbimeve duhet t' i mundësojë konsumatorit njoftim paraprak me të gjitha kushtet e shfrytëzimit të shërbimeve publike dhe këto kushte duhet t' i publikojë në media.

Neni 22 B
Ndërprerja e ofrimit të shërbimeve publike

1. Nëse fatura e ofruesit të shërbimit publik kontestohet nga konsumatori në cilëndo procedurë gjyqësore ose jashtë gjyqësore, ndërsa konsumatori i paguan rregullisht të gjitha faturat e pakontestueshme, ofruesi i shërbimit publik nuk ka të drejtë t'ia ndërpres konsumatorit shërbimin deri në përfundimin e procedurës gjyqësore ose jashtë gjyqësore.

2. Në qoftë se ofruesi i shërbimit publik ka ndërprerë ofrimin e shërbimit para se të jetë njoftuar nga personi kompetent për procedurën e ngritur nga paragrafi 1 i këtij neni, ai është i obliguar të fillojë përsëri ofrimin e shërbimit për konsumatorin, deri në përfundimin procedurës gjyqësore ose jashtëgjyqësore.

Neni 22 C
Mirëmbajtja e cilësisë së shërbimit publik

1. Ofruesi i shërbimeve publike duhet të ruajë cilësinë e shërbimeve në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi.

2. Institucionet kompetente të cilat japin autorizime për kryerjen e shërbimeve publike, janë të obliguara të sigurojnë fushëveprimin e kompetencave të veta të caktuara me ligj që i autorizuari të ofrojë shërbime duke i kushtuar kujdes sigurisë, furnizimit të rregullt dhe cilësisë së shërbimit publik i cili shfrytëzohet nga konsumatori.

Neni 7

Në nenin 26. paragrafi 26.3 pas pikës (c) shtohet pika (d) me tekstin si vijon:

d) Ndalohet publikimi nëse është ose ka elemente diskriminimi për gjininë, racën, fenë, kombësinë, bindjen politike, moshën ose veçorin fizike dhe mendore.

Neni 8

Në nenin 28 pas paragrafit 28.2 shtohet paragrafi i ri me tekstin si vijon:

3. Në vend të subjektit që i promovon mallrat ose shërbimet e veta përgjigjen agjencitë publicitare, sipas këtij ligji për publikimin e tyre të padrejtë, mashtrues dhe krahasues.

Neni 9

Pas nenit 31 shtohet nen i ri 31 A me tekstin si vijon:

Neni 31 A
Kontratat në largësi

1. Tregtari dhe konsumatori mund të lidhin kontratë në largësi, për shitblerje malli ose për ofrim të shërbimit, sipas një skeme organizimi për shitje ose për shërbim në largësi, duke përdorur veçanërisht një ose më shumë mjete të komunikimit në largësi.

2. Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pa pasoja brenda 7 (shtatë) ditëve të punës, nga dita e marrjes së mallit, nëse nuk i përmbush kërkesat sipas kontratës, si dhe në të njëjtin afat për shërbime, nëse shërbimi nuk është kryer sipas cilësisë ose afatit të përcaktuar me kontratë.

3. Tregtari duhet të përmbushë porosinë e marrë nga konsumatori në harmoni kontratës.

Neni 10

Në nenin 32. paragrafi 32.4 fshihet ndërsa paragrafët 32.2 dhe 32.3 ndryshohen dhe zëvendësohen me tekstin si vijon:

2. Programi i Kosovës për mbrojtjen e konsumatorëve do të përgatitet nga Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve.

3. Programi i Kosovës për mbrojtjen e Konsumatorëve aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 11

Pas nenit 33 shtohet nen i ri 33 A me tekstin si vijon:

Neni 33 A

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë themelon dhe emëron Këshillin për mbrojtjen e konsumatorëve në kohëzgjatje prej katër (4) vitesh.

2. Këshilli i ka shtatë (7) anëtarë dhe kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë.

3. Këshilli përbëhet prej përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve, përfaqësuesve të bizneseve dhe eksperteve nga lëmenjtë përkatëse.

4. Këshilli është trup këshillëdhënës.

5. Këshilli e nxjerr Rregulloren e punës, ndërsa e miraton Ministri i Tregtisë dhe i Industrisë.

Neni 12

Në nenin 34 pas paragrafit 34.6 shtohen tri paragrafë të rinj me tekstin si vijon:

7. Shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve mund të bashkohen dhe të formojnë asociacionin e shoqatave për mbrojtjen e Konsumatorëve.

8. Asociacioni i shoqatave vepron në bazë të Statutit dhe ka organet e veta.

9. Shoqata e konsumatorëve mund të kërkojë mbështetje pa pagesë nga mediat publike, në rast se janë prekur interesat e konsumatorit, duke i transmetuar njoftimet e tyre në publik.

Neni 13

Pas nenit 34 shtohet nen i ri 34 A me tekstin si vijon:

Neni 34 A Informimi dhe edukimi i konsumatorit

1. Planet dhe programet mësimore për shkollim fillor dhe për shkollim të mesëm duhet të përmbajnë njohuri themelore për të drejtat dhe për detyrimet që dalin nga parimet themelore dhe nga aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e konsumatorit.
2. Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, në kuadër të planeve e programeve arsimore, inkorporon dhe miraton programe edukativo-arsimore për mbrojtjen e konsumatorit.
3. Ministria bashkëpunon më institucionet edukativo-arsimore, dhe zbaton aktivitete të tjera arsimore- edukative të informimit dhe edukimit nga fusha e mbrojtës së konsumatorit.

Neni 14

Në nenin 41. paragrafi 41.1 pas pikës (f) shtohet pika (g) me tekstin si vijon;

g) Tregtari që nuk ia dhuron konsumatorit mallin e paraparë për dhurim, sipas shpalljes publike (nenit 14 A), gjobitet në pajtim me nenin 41.1 të këtij ligji.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-131
12 mars 2009**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-009-2009, datë 03.04.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.**